

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës–Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit Z.B., për shkak të veprave penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj dhe përgjigjes në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit av. V.J., të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.71/2018, të dt. 07.06.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konformë dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, më datë 19.12.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.71/2018, të dt. 07.06.2018, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.71/2018, të dt. 07.06.2018, i akuzuari Z.B., është shpallur fajtor për shkak të veprave penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, dhe për këto vepra penale, pasi më parë i është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 2 (dy) vjet nuk kryen vepër tjetër penale dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 €, ndërsa, për veprën e dytë penale me dënim me gjobë në shumë prej 300 €, me aplikimin e dispozitave për shqiptimin e dënimit për veprat penale në bashkim, bazuar në dispozitat e nenit 80 të KPK-së, të akuzuarin e ka gjykuar me dënim unik me gjobë në shumë prej 600 €, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, ndërsa, i akuzuari refuzon ta paguajë dënimin me gjobë, atëherë, i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do t'i llogaritet në shumë prej 20 €, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 2 (dy) vjet, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

Në dënimin e shqiptuar me gjobë, të akuzuarit i është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 31.12.2017 deri më dt. 30.01.2018.

Të akuzuarit, po ashtu, i ka shqiptuar dënimin plotësues – konfiskimin e armës të tipit AK-47 kal: 7.62 m.m, me numër serik B-58994, si mjet me të cilin është kryer vepra penale.

Të akuzuarin e ka detyruar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 (tridhjetë) €, si dhe në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të dhunës shumë prej 50 (pesëdhjetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Përgjigje në ankesën e prokurorisë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit Z.B., av. V.J., me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar ndërsa, aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë kanë paraqitur Prokuroria Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i lartë me burg efektiv, për veprat e kryera penale se sa dënimi i shqiptuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e mbajti konformë dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK-së, pa informimin e palëve, ngase, nuk ka bazë ligjore për informim të obligueshëm të palëve.

Prokuroria e Apelit, përmes parashtresës PPA/I.nr.545/2018, të dt.11.12.2018, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, të aprovet si e bazuar, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me burg efektiv dhe dënim më i lartë me gjobë.

Gjykata e Apelit, pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në ankesa, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Me ankesën e paraqitur edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit, të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konformë dispozitës së nenit 394 të KPPK-së, dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu, as gjendja e fakteve nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase as me ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë – neni 383 par.2 të KPPK, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, nuk janë të bazuara.

Prokuroria Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, në ankesë pretendon se dënimi i shqiptuar është i butë dhe jo proporcional me peshën e veprës penale si dhe me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, pastaj, shkallën e përgjegjesisë penale të akuzuarit, se përveç rrethanave lehtësuese që janë konstatuar në aktgjykimin e ankimuar, se i akuzuari ka pranuar fajësinë, është penduar, është i gjendjes së varfër ekonomike, baba i pesë fëmijëve, mbajtës i vetëm i familjes, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë vepër tjetër penale, nuk janë marrë parasysh edhe rrethanat rënduese, si shkalla e përgjegjesisë penale të akuzuarit, vlerat e mbrojtura juridike, mënyra e kryerjes së veprës penale, pastaj, motivi që e ka shtyrë të akuzuarin të kryejë vepër tjetër penale, rrethana këto të gjitha që arsyetojnë shqiptimin e dënimit më të ashpër, se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e lartpërmendura ankimore nuk qëndrojnë ngase gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse jo vetëm që i ka konstatuar rrethanat, por të njëjtat drejt i ka vlerësuar sikur që parashihet në dispozitat e nenit 73 të KPK-së, kështu, që rrethanat që cekën në ankesë janë kryesisht rrethana të përgjithësuara e pa cekur fakte konkrete në kuptim të rrethanave rënduese, ndërsa, disa nga ato rrethana të cilat janë të inkorporuara në elementet e veprës penale, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor. Prandaj, duke pasur parasysh rrethanat e cekura më lartë, rrethanat e rastit konkret të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, e sidomos gjendjen e tij familjare – pra i njëjti përveç që është mbajtës i familjes është edhe baba i pesë fëmijëve, është i pa punë, mbajtës i vetëm i familjes, i gjendjes së varfër ekonomike-realizon të ardhura mujore në shumë prej 170 € dhe atë në emër të pensionit invalidor, se i njëjti qysh në fazën e parë të procedurës penale e ka pranuar fajësinë, pastaj, është penduar për kryerjen e veprës penale, e në mungesë të rrethanave posaçërisht rënduese, kjo gjykatë konsideron se dënimi i shqiptuar me burgim i cili pastaj i është kushtëzuar të akuzuarit si dhe dënimi me gjobe, është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe me shkallën e përgjegjesisë së të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryerjes nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, ta bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të ndikojë edhe në personat e tjerë që të mos kryejnë vepra penale, duke konsideruar kështu se me dënimin e shqiptuar me kusht- pra edhe me kërcënim me dënim, si dhe dënimi me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë, e konformë dispozitës së nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.575/2018, të dt. 19.12.2018

Procesmbajtësi,

Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit,

1.Xhevdet Abazi

2.Afrim Shala

Kryetar i kolegjit,

Abdullah Ahmeti

